



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912676

Datë: 29.01.2021

Numri i dokumentit: 01454669

AC.nr. 975/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim përfaqësuesja nga Avokatura Shtetërore e Ministrisë së Drejtësisë, N.K. nga Prishtina, kundër të paditurit I.T. nga fshati ... Komuna e Deçanit, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 1.286.00 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.255/17 të datës 21.06.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 12.01.2021 mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e përfaqësuesit të paditurit I.T. nga fshati ... Komuna e Deçanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.255/17 i datës 21.06.2018, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, aprovet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë. Në pikën II të dispozitivit, detyrohet i padituri I.T. nga fshati ... Komuna e Deçanit, që paditëses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar t'ia paguaj shumën prej 1.286.00€ (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë euro) në xhirollogarinë bankare të paditëses Qeveria e Kosovës-Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me numër 1000400070002120, me kamatë në lartësi prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me dt.11.09.2017 e deri në pagesën definitive. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit me dhunë. Me të njëjtin aktgjykim në paragrafin III të dispozitivit, është vendosur që secila palë i bart vet shpenzimet e procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave procedurale dhe cenimit të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të anulohet dhe i padituri të lirohet nga pagesa e kompensimit të dëmit ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja, ka paraqitur padi kundër të paditurit, në gjykatën e shkallës së parë me dt.11.09.2017, për kompensim dëmi. Nga paditësja është theksuar se, i padituri me dt.29.05.2015, rreth orës 15:10 min, kishte shkuar në vendin e quajtur “Zharret e ...es”, që është në pjesën e territorit të Parkut Kombëtar, me qëllim të vjedhjes ka bërë prerjen me motor-sharrë, ashtu që duke i transportuar me automjetin e tij 11 trupa të llojit brehu-ahu, me vëllim të përgjithshëm prej 3.32m³, ku ndalohet shpenzimi ekonomik i të mirave të natyrës, duke i shkaktuar kështu dëm material paditëses në shumën prej 1.286.00 €. Ndërkaq, përfaqësuesja e paditëses, gjatë seancave ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadiisë, duke kërkuar aprovimin e tërësishëm të saj. Konsideron se, baza juridike e kërkesëpadiisë dhe lartësia e saj janë vërtetuar me prova dhe i padituri të detyrohet nga gjykata për kompensimin e dëmit, se bashku me kamatën në lartësi prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë dt.11.09.2017 deri në pagesën definitive.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 8 të LPK-ës, ka marr aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadiinë e paditëses, me detaje të tjera të përshkruara më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë theksohet se, me Aktgjykim penal nr.P.nr.67/2017 të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan të dt.11.07.2017, i pandehuri tani i padituri I.T., është shpallur fajtor dhe është dënuar nga gjykata. Pastaj, nga fletëparaqitja e rojtarit të natyrës të Parkut Kombëtar nr.1/37 e dt.01.06.2015, e paraqitur kundër të paditurit I.T., rezulton se, i njëjti është hasur me dt.29.05.2015, në vendin e quajtur “Zharret e ...es”, që është në pjesën e territorit të Parkut Kombëtar, me qëllim të vjedhjes ka bërë prerjen me motor-sharrë dhe duke i transportuar me automjetin e tij, 11 trupa të llojit brehu-ahu me vëllim të përgjithshëm prej 3.32m³, ku ndalohet shpenzimi ekonomik i të mirave të natyrës, duke i shkaktuar dëm material paditëses në shumën prej 1.286.00€. Gjykata e shkallës së parë, vlerën e dëmit material e ka përcaktuar sipas Rregullores së MMPH, nr.01/2015 të dt.19.07.2015 dhe atë në shumë prej 1.286.00€, dëm të cilin i padituri i ka shkaktuar paditëses.

Këtë gjendje faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 136, 140, 169 par.1, 3, 4 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe nenit 463 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pra, nuk qëndron pretendimi ankimor i përgjithësuar i të paditurit, për shkelje të dispozitave procedurale e të cilat shkelje edhe ashtu nuk i ka konkretizuar, sepse në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë siç u theksua edhe më sipër, nuk ka shkelur dispozitat e procedurës, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as ndonjë dispozitë tjetër e cila do të ndikonte në drejtëshmërinë dhe ligjshmërisë e aktgjykimit të atakuar.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se, është i pa pabazuar edhe pretendimi ankimor për vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë, pasi që ka siguruar provat e nevojshme të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, të cilat vërtetohen me argumente, përfshirë këtu edhe fotografitë e bëra në vend të ngjarjes, si dhe fletëparaqitjen e cila i është bërë të paditurit me nr.1/37 e dt.01.06.2015. Pastaj është konstatuar edhe gjendja faktike e cila ka rezultuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, me nr. P.nr.67/2017 i dt.11.07.2017, ku i pandehuri-tani i padituri, është shpallur fajtor, pikërisht për këtë veprë penale të vjedhjes së pyllit, nga neni 358 par.2 të KPRK-së dhe i njëjti është gjykuar me dënim me kusht, me urdhër për mbikëqyrjen nga Shërbimi Sprovues, pra, është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 8 muaj me kusht, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 1,000€, me kusht që i njëjti në afat prej 2 viteve nuk kryen ndonjë veprë të re penale, me detaje të tjera të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit penal.

Pra, fajësia dhe përgjegjësia e të paditurit, si dhe vëllimi dhe vlera e demit të shkaktuar paditëses, është vërtetuar me aktgjykimin penal të sipër cekur. Kështu që, mbi këtë bazë gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje kontestimore, kështu që, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit në këtë aspekt dhe si i tillë u refuzua nga kjo gjykatë.

Duke qenë se në këtë çështje kontestimore të paditëses, gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke mos bërë shkelje esenciale të procedurës, kështu që në këtë gjendje të vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, kur gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar i referohet dispozitave konkrete përkatëse ligjore.

Me dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së në mënyrë eksplicite është përcaktuar se “ *kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Kështu që në rastin konkret, i padituri bazuar në faktin se i njëjti me aktgjykim penal të gjykatës së shkallës së parë është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale të vjedhjes së pyllit, ku janë përshkruar prerja me motor-sharrë dhe transportimi me automjetin e tij, 11 trupa të llojit brehu-ahut, që përbejnë vëllimin e përgjithshëm 3.32m³, ku me veprimet e tij i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarës-tani paditëses në vlerë prej 1.286.00€, kështu që, edhe baza edhe lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar drejtë nga gjykata e shkallës së parë, ashtu që në këtë aspekt, pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme dhe si të tilla u refuzuan nga Gjykata e Apelit.

Nuk kontestohet fakti se, vendi ku ka ndodhur zjarri aksidental me dt.05.09.2013, rreth orës 13:30, gjendej në shtëpinë e I.T. në fshatin ..., sepse, i padituri me ankesë ka bashkangjitur raportin e veçantë të policisë të dt.05.09.2013, por megjithatë, veprimet e ndërmarra nga i padituri për prerjen e drunjëve me shënimet e cekura si më lartë, nuk e arsyetojnë këtë, sepse siç ka vërtetuar edhe gjykata e shkallës së parë në procedurë penale, veprimet e të paditurit atëherë të pandehurit, janë konsideruar vepër penale. Edhe pse, ndoshta qëllimi i të paditurit ka qenë që me drunjte e prerë të siguroj mbulesën e pullazit të shtëpisë së tij, përsëri kjo nuk arsyetohet, sepse prerje të drunjëve në zonën siç ka ndodhur në rastin konkret, janë të ndaluara me ligj.

Dihet se, gjatë vendosjes në procedurë kontestimore lidhur me një çështje e cila është si pasojë e një vepre penale, siç është kjo edhe në rastin konkret me të paditurin, atëherë gjykata duhet të veproj edhe sipas nenit 14 të LPK-së, ku decidivisht parashihet se *“në procedurën kontestimore, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*.

Sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron as pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është dashur që të siguroj si provë shkresat e lëndës C.nr.213/13 të dt.12.11.2015, ku është kërkuar kompensimi i dëmit, për djegien e shtëpisë nga pasojat e rrymës elektrike, sepse vepra e tillë e kryer nga i padituri, nuk ndërlihet me këtë pretendim ankimor të paditurit dhe është irelevante për vendosje ndryshe. Edhe sa i përket llogaritjes së dëmit të shkaktuar, gjykata ka pasur parasysh provat të cilat kanë ekzistuar në këtë lëndë ashtu që pretendimi ankimor për dëmin e shkaktuar nuk qëndron.

Po ashtu është irelevante në këtë fazë të procedurës në gjykatën e shkallës së dytë, ku i padituri ka pretenduar për gjendje ekonomike dhe sociale të rënduar, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka tagër që të marrë vendime të natyrës që kanë të bëjnë me mirëqenien sociale, nga se kjo u takon organeve tjera administrative të komunës përkatëse, e kurrsesi gjykatës.

Gjykata e Apelit vlerëson se, pretendimet ankimore të paditurit në këtë aspekt nuk patën ndonjë ndikim, që Gjykata e Apelit të anuloj aktgjykimin e atakuar apo eventualisht lëndën ta kthej në rigjykim, siç pretendohet me ankesën e paraqitur.

Me sa u tha më lartë, e meqë gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkeljet esenciale për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, në bazë të nenit 195 par.1 pika d) të LPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
AC.nr. 975/2019 me dt.12.01.2021

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni

Numri i lëndës: 2020:912676
Datë: 29.01.2021
Numri i dokumentit: 01454669